



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS

## RREGULLORJA E SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Ofrimi i shërbimeve administrative përmes Sistemit të  
Integruar të Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N)

---



## Përmbajtja

Procesi i hartimit të rregullores së procedurave administrative .....	5
Qëllimi i Rregullores .....	5
Fusha e zbatimit .....	5
Rastet e vecanta të aplikimit dhe shqyrtimit të shërbimeve administrative .....	6
Hartimi dhe finalizimi i rregullores së procedurave administrative.....	9
Verifikimi për shlyerjen e detyrimeve vendore .....	9
Tarifimi i shërbimeve .....	10
Sektori i Shërbimeve Publike .....	11
Lista e shërbimeve .....	11
Baza ligjore.....	12
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Bashkisë Vau i Dejës .....	13
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative me sistemin Z1N17	
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative pa sistem.....	22
Sektori i Urbanistikës, kadastër .....	23
Lista e shërbimeve .....	23
Baza ligjore.....	23
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Bashkisë Vau i Dejës .....	24
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative me sistemin Z1N28	
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative pa sistem.....	32
Sektori i Ndhmës Ekonomike .....	33
Lista e shërbimeve .....	33
Baza ligjore.....	33
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Bashkisë Vau i Dejës .....	34
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative me sistemin Z1N36	
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative pa sistem.....	38
Sektori i Ndhmës Ekonomike /Vërtetimet e Ndhmës Ekonomike .....	39

Lista e shërbimeve.....	39
Baza ligjore.....	39
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Bashkisë Vau i Dejës .....	40
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative me sistemin Z1N42	
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative pa sistem.....	43
Sektori i Buxhetit e Financës .....	44
Lista e shërbimeve.....	44
Baza ligjore.....	44
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Bashkisë Vau i Dejës .....	45
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative me sistemin Z1N49	
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative pa sistem.....	53
Sektori i Bujqësisë.....	54
Lista e shërbimeve.....	54
Baza ligjore.....	54
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Bashkisë Vau i Dejës .....	55
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative me sistemin Z1N59	
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative pa sistem.....	64
Sektori i të Ardhurave.....	65
Lista e shërbimeve.....	65
Baza ligjore.....	65
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Bashkisë Vau i Dejës .....	66
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative me sistemin Z1N69	
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative pa sistem .....	73
Sektori i Emergjencave Civile .....	74
Lista e shërbimeve.....	74
Baza ligjore.....	74
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Bashkisë Vau i Dejës .....	75
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative me sistemin Z1N77	

Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative pa sistem.....	79
Sektori i Arsimit.....	80
Lista e shërbimeve.....	80
Baza ligjore.....	80
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Bashkisë Vau i Dejës.....	81
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative me sistemin Z1N83	
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative pa sistem.....	86
Shërbime të përgjithshme .....	87
Lista e shërbimeve.....	87
Baza ligjore:.....	87
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Bashkisë Vau i Dejës.....	88
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative me sistemin Z1N90	
Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative pa sistem.....	92
Proçedura për ndryshimin e proçedurave administrative për shërbimet që ofrohen nga zyra e integruar me një ndalesë .....	93

## **Procesi i hartimit të rregullores së procedurave administrative**

Me rregullore procedurash administrative kuptojmë tërësinë e rregullave me të cilat rregullohet procesimi (veprimi) i ofrimit të shërbimeve administrative, duke zbatuar rregullat e përgjithshme, të drejtat, detyrimet ose interesat e palëve në procedurën administrative. Proçedurat administrative janë zhvilluar si rezultat i metodologjisë që konsiston në identifikimin e shërbimeve administrative që ofrohen në Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe riinxhinerimin e proçeseve me qëllim për të zhvilluar një model shërbimesh që është i përshtatshëm për t'u implementuar dhe ekzekutuar nëpërmjet modelit SiZ1N.

### **Qëllimi i Rregullores**

Kjo rregullore ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të procedurave administrative në funksion të ofrimit të shërbimeve aplikantëve në mënyrë cilësore, në kohë më të shkurtër dhe kosto më të ulët duke zbatuar parimin e proçesit të rregullt ligjor.

### **Fusha e zbatimit**

- ✓ Rregullat e përgjithshme të procedurave administrative zbatohen nga e gjithë administrata e Bashkisë Vau Dejës gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre nëpërmjet Sistemit të Integruar të Zyrave me Një Ndalesë.
- ✓ Rregullat e përgjithshme të procedurave administrative bëhen të detyrueshme për zbatim për administratën e Njësive Administrative që kanë të implementuar Sistemin e Integruar të Zyrave me Një Ndalesë.
- ✓ Rregullat e përgjithshme të procedurave administrative mund të bëhen të detyrueshme për zbatim edhe për administratën e Njësive Administrative që nuk e kanë të implementuar Sistemin e Integruar të Zyrave me Një Ndalesë, por në funksion të ofrimit të shërbimeve banorëve, shqyrtimi i kërkesave kryhet në ato Njësi Administrative që e kanë të Implementuar Sistemin e Integruar të Zyrave me Një Ndalesë.
- ✓ Kërkesat të cilat nuk kanë një emërtim të përcaktuar qartë të llojit të shërbimit dhe që nuk funksionojnë si të tilla në Sistemin e Integruar të Zyrave me Një Ndalesë, sipas tematikës së kërkesës do i drejtohen drejtorisë që mbulon funksionet e caktuara.

## **Rastet e vecanta të aplikimit dhe shqyrtimit të shërbimeve administrative**

Janë evidentuar gjashtë raste të aplikimit për shërbime administrative për të cilat shqyrtimi i tyre kryehet në varësi të vendodhjes dhe natyrës së shërbimit;

### ***Rasti i parë:***

- a) Kërkesa për shërbim kryhet pranë Zyrës me Një Ndalesë të Bashkisë Vau i Dejës.
- b) Verifikimi për shlyerjen e detyrimeve vendore kryhet në Sektorin e të Ardhurave, në Bashkinë Vau i Dejës.
- c) Faturimi dhe vjelja e detyrimeve të taksave vendore kryhet nga Sektori i të Ardhurave në rastet kur rezultojnë detyrime të pashlyera, bazuar në Paketën Fiskale të vitit përkatës fiskal. Fatura për arkëtim lëshohet nga Zyra me Një Ndalesë pranë Bashkisë Vau Dejës. Rregjistrimi i mandat pagesës pas shlyerjes së detyrimeve do të kryhet pranë Zyrës me Një Ndalesë.
- d) Shqyrtimi i kërkesës bëhet në Zyrat Prodhuese (Drejtoria përgjegjëse për shërbimin e kërkuar sipas funksioneve dhe detyrave që kryen), në Bashkinë Vau i Dejës.
- e) Faturimi dhe vjelja e tarifës së shërbimeve kryhet nga Sektori i të Ardhurave, bazuar në Paketën Fiskale në Bashkinë Vau i Dejës. Fatura për arkëtim lëshohet nga Zyra me Një Ndalesë pranë Bashkisë Vau Dejës. Rregjistrimi i mandat pagesës pas kryerjes së pagesës do të kryhet pranë Zyrës me Një Ndalesë.
- f) Dokumenti i përgjigjes firmoset në Bashkinë Vau i Dejës dhe i dorëzohet aplikantit pranë Zyrës me Një Ndalesë.

### ***Rasti i dytë:***

- a) Kërkesa për shërbim kryhet pranë Zyrës me Një Ndalesë në Njësitë Administrative që kanë të implementuar Sistemin e Integruar të Zyrave me Një Ndalesë.
- b) Verifikimi për shlyerjen e detyrimeve vendore kryhet në Njësi Administrative.
- c) Faturimi dhe vjelja e detyrimeve të taksave vendore kryhet nga Sektori i të Ardhurave në Njësi Administrative bazuar në Paketën Fiskale të vitit përkatës fiskal, në rastet kur rezultojnë detyrime të pashlyera. Fatura për arkëtim lëshohet pranë Zyës me Një Ndalesë të Njësisë Administrative. Rregjistrimi i mandat pagesës pas shlyerjes së detyrimeve do të kryhet pranë Zyrës me Një Ndalesë të Njësisë Administrative.
- d) Shqyrtimi i kërkesës bëhet në Zyrat Prodhuese (Drejtoria përgjegjëse për shërbimin e kërkuar sipas funksioneve dhe detyrave që kryen), në Bashkinë Vau i Dejës.
- e) Faturimi dhe vjelja e tarifës së shërbimeve kryhet nga Sektori i të Ardhurave, bazuar në Paketën Fiskale në Bashkinë Vau i Dejës. Fatura për arkëtim lëshohet pranë Zyrës me Një

Ndalesë të Njesisë Administrative. Rregjistrimi i mandat pagesës pas kryerjes së pagesës do të kryhet pranë pranë Zyrës me Një Ndalesë të Njesisë Administrative.

f) Dokumenti i përgjigjes firmoset në Bashkinë Vau i Dejës dhe i dorëzohet aplikantit pranë Zyrës me Një Ndalesë të Njesisë Administrative.

### ***Rasti i tretë:***

a)Kërkesa për shërbim kryhet pranë Zyrës me Një Ndalesë në Njësitë Administrative që kanë të implementuar Sistemin e Integruar të Zyrave me Një Ndalesë.

b)Verifikimi për shlyerjen e detyrimeve vendore kryhet në Njësi Administrative.

c)Faturimi dhe vjelja e detyrimeve të taksave vendore kryhet nga Sektori i të Ardhurave në Njësi Administrative bazuar në Paketën Fiskale të vitit përkatës fiskal, në rastet kur rezultojnë detyrime të pashlyera. Fatura për arkëtim lëshohet pranë Zyës me Një Ndalesë të Njesisë Administrative. Rregjistrimi i mandat pagesës pas shlyerjes së detyrimeve do të kryhet pranë Zyrës me Një Ndalesë të Njesisë Administrative.

d)Shqyrtimi i kërkesës bëhet në Zyrat Prodhuese (Drejtoria përgjegjëse për shërbimin e kërkuar sipas funksioneve dhe detyrave që kryen), në Bashkinë Vau i Dejës.

e)Faturimi dhe vjelja e tarifës së shërbimeve kryhet nga Sektori i të Ardhurave, bazuar në Paketën Fiskale në Bashkinë Vau i Dejës. Fatura për arkëtim lëshohet pranë Zyrës me Një Ndalesë të Njesisë Administrative. Rregjistrimi i mandat pagesës pas kryerjes së pagesës do të kryhet pranë Zyrës me Një Ndalesë të Njesisë Administrative.

f)Dokumentit i përgjigjes firmoset në Njësinë Administrative nga Administratori i Njesisë dhe i dorëzohet aplikantit pranë Zyrës me Një Ndalesë të Njesisë Administrative.

### ***Rasti i katërt***

a)Kërkesa për shërbim kryhet pranë Zyrës me Një Ndalesë në Njësitë Administrative që kanë të implementuar Sistemin e Integruar të Zyrave me Një Ndalesë.

b)Verifikimi për shlyerjen e detyrimeve vendore kryhet në Njësi Administrative.

c)Faturimi dhe vjelja e detyrimeve të taksave vendore kryhet nga Sektori i të Ardhurave në Njësi Administrative bazuar në Paketën Fiskale të vitit përkatës fiskal, në rastet kur rezultojnë detyrime të pashlyera. Fatura për arkëtim lëshohet pranë Zyës me Një Ndalesë të Njesisë Administrative. Rregjistrimi i mandat pagesës pas shlyerjes së detyrimeve do të kryhet pranë Zyrës me Një Ndalesë të Njesisë Administrative.

d)Shqyrtimi i kërkesës bëhet në Zyrat Prodhuese (Drejtoria përgjegjëse për shërbimin e kërkuar sipas funksioneve dhe detyrave që kryen), në Njësi Administrative.

e)Faturimi dhe vjelja e tarifës së shërbimeve kryhet nga Sektori i të Ardhurave, bazuar në Paketën Fiskale në Njësi Administrative. Fatura për arkëtim lëshohet pranë Zyrës me Një Ndalesë të Njesisë Administrative. Rregjistrimi i mandat pagesës pas kryerjes së pagesës do të kryhet pranë Zyrës me Një Ndalesë të Njesisë Administrative.

f)Dokumenti i përgjigjes firmoset në Njësinë Administrative nga Administratori i Njesisë dhe i dorëzohet aplikantit pranë Zyrës me Një Ndalesë të Njesisë Administrative.

### ***Rasti i pestë***

a)Kërkesa për shërbim kryhet pranë Njësive Administrative që nuk kanë të implementuar Sistemin e Zyrave të Integruara me Një Ndalesë.

b)Verifikimi për shlyerjen e detyrimeve vendore kryhet në Njësi Administrative.

c)Faturimi dhe vjelja e detyrimeve të taksave vendore kryhet nga Sektori i të Ardhurave në Njësi Administrative bazuar në Paketën Fiskale të vitit përkatës fiskal, në rastet kur rezultojnë detyrime të pashlyera.

d)Shqyrtimi i kërkesës bëhet në Zyrat Prodhuese (Drejtoria përgjegjëse për shërbimin e kërkuar sipas funksioneve dhe detyrave që kryen), në Bashkinë Vau Dejës.

e)Faturimi dhe vjelja e tarifës së shërbimeve kryhet nga Sektori i të Ardhurave në Bashkinë Vau Dejës, bazuar në Paketën Fiskale. Fatura për arkëtim lëshohet pranë Njesisë Administrative. Rregjistrimi i mandat pagesës pas shlyerjes së detyrimeve do të kryhet pranë Njesisë Administrative.

f)Dokumenti i përgjigjes firmoset në Bashkinë Vau Dejës dhe i dorëzohet aplikantit në Njësi Administrative.

### ***Rasti i gjashtë***

a)Kërkesa për shërbim kryhet pranë Njësive Administrative që nuk kanë të implementuar Sistemin e Integruar të Zyrave me Një Ndalesë.

b)Verifikimi për shlyerjen e detyrimeve vendore kryhet në Njësi Administrative.

c)Faturimi dhe vjelja e detyrimeve të taksave vendore kryhet nga Sektori i të Ardhurave në Njësi Administrative bazuar në Paketën Fiskale të vitit përkatës fiskal, në rastet kur rezultojnë detyrime të pashlyera.

d)Shqyrtimi i kërkesës bëhet në Zyrat Prodhuese (Drejtoria përgjegjëse për shërbimin e kërkuar sipas funksioneve dhe detyrave që kryen), në Njësi Administrative.

e)Faturimi dhe vjelja e tarifës së shërbimeve kryhet nga Sektori i të Ardhurave, bazuar në Paketën Fiskale. Fatura për arkëtim lëshohet pranë Njesisë Administrative.



f) Dokumenti i përgjigjes firmoset në Njësi Administrative nga Administratori i Njësisë dhe i dorëzohet aplikantit.

### **Hartimi dhe finalizimi i rregullores së procedurave administrative**

Rregullorja e procedurave administrative është hartuar bazuar në strukturën organizative të hartuar nga Bashkia Vau i Dejës , për vitin 2016. Shqyrtimi i shërbimeve është bërë duke u bazuar në sektor.

Secili sektor përfshinë një numër të madhë shërbimesh, por kjo rregullore procedurash nuk është përgjithësuse. Rregullorja shpjegon dhe trajton vetëm ato shërbime administrative të cilat shqyrtohen nëpërmjet Sistemit të Integruar të Zyrave me Një Ndalesë.

### **Verifikimi për shlyerjen e detyrimeve vendore**

Për çdo aplikant, që paraqitet në sportelet e Zyrave me Një Ndalesë në Bashki dhe në Njësi Administrative, shqyrtimi i shërbimeve administrative kryhet vetëm pasi Sektori i të Ardhurave ka verifikuar nëse aplikanti (individ/person fizik/person juridik) ka shlyer detyrimet vendore, bazur në Paketën fiskale të vitit respektiv..

Në rastin kur individi nuk ka shlyer detyrimet vendore, Sektori të Ardhurave përgatit faturën me detyrimet e pashlyera. Specialistët e Zyrës me Një Ndalesë janë përgjegjës për dorëzimin e faturës për arkëtim aplikantit dhe bashkëngjitjes së mandat pagesës në sistem pasi aplikanti ka likuaduar faturën.

Në rastet kur aplikanti paraqitet për të bërë një ankesë, kërkesë për informacion apo kërkesë të përgjithshme nuk është e nevojshme që kërkesat të kalojnë për verifikimin e shlyerjes së detyrimeve vendore.

Struktura e ngarkuar për Verifikimin e Detyrimeve Vendore:

1. Për verifikimin e shlyerjes së detyrimeve vendore për familjarët dhe bizneset në Bashkinë Vau i Dejës ngarkohet Sektori i të Ardhurave.
2. Në rast se kërkesa është bërë në Njësinë Administrative Bushat, verifikimin për shlyerjen e detyrimeve do ta kryejë Inspektori i Tatim-Taksave.

## **Tarifimi i shërbimeve**

Drejtoritë përgjegjëse për shqyrtimin e shërbimeve pasi marrin vendimin për miratimin e kërkesave, përcjellin informacionin dhe llogaritjen e detyrimit tek Sektori i të Ardhurave. Tarifat mbulohen nga subjekti që përfiton shërbimin. Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimeve është Sektori i të Ardhurave.

Faturat për shlyerjen e tarifës së shërbimit i përcillen përmes sistemit specialistëve të Z1N dhe i dorëzohen aplikantëve nga specialistët e Z1N në Bashkinë Vau Dejës ose në Njësitë Administrative të cilat kanë të instaluar Sistemin Z1N.

## **Sektori i Shërbimeve Publike**

### **Lista e shërbimeve**

Sektori i shërbimeve publike, në Bashkinë Vau i Dejës dhe Njësitë Administrative ofron këto shërbime:

1. Liçensë për transport udhëtarësh me taksi
2. Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet
3. Çertifikatë për transport udhëtarësh brenda vendit për llogari të vet
4. Liçensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse
5. Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse
6. Liçensë për transport udhëtarësh në linje të rregullt qytetëse
7. Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse
8. Liçensë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit
9. Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit
10. Liçencë për transport në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve
11. Çertifikatë për transport në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve
12. Liçencë për agjenci transport udhëtarësh dhe shërbimi taksi brenda vendit
13. Liçence për agjenci transporti ndërkombëtar udhëtarësh
14. Autorizim për lëvizje jashtë linje pa ndalesë
15. Autorizim Qarkullimi
16. Liçensë për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikantë
17. Liçencë për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë
18. Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut
19. Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut
20. Autorizim për transport udhëtarësh me taksi 8 plus 1 brenda qarkut
21. Kërkesë për vend parkim të rezervuar

## Baza ligjore

Hartimi i procedurave administrative dhe formularëve-tip, është mbështetur në legjislacionin e mëposhtëm;

- ✓ Ligji Nr. 8308, dt. 18.03.1998 "Për Transportet Rrugore", të ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr. 8378, dt. 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë";
- ✓ Ligj Nr.10 164, datë 15.10.2009 "Për autoritetin rrugor shqiptar";
- ✓ Ligj Nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
- ✓ Ligji Nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar;
- ✓ Vendim Nr.474, datë 29.7. 1998 "Për dokumentacionin që evidenton dhe shoqëron mjetet e transportit të mallrave në levizje";
- ✓ VKM Nr. 170,dt. 25-04-2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës , gazit e nënprodukteve të tyre", të ndryshuar
- ✓ Udhëzim Nr. 15, dt. 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", i ndryshuar
- ✓ Udhëzim Nr.20, dt. 10.10.2007, për "Modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" i ndryshuar si dhe Vendimeve përkatëse të Këshillit Bashkiak;
- ✓ Udhëzim Nr.1, datë 28.1.2009 "Për pajisjen me certifikatën e kompetencës profesionale të drejtuesit të veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor"
- ✓ Vendim, Nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj".

## **Procedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Bashkisë Vau i Dejës**

### **Pranimi i kërkesës**

Në momentin që një aplikant paraqitet pranë sportelit të Z1N në Bashkinë Vau i Dejës për të aplikuar për një shërbim të transportit rrugorë (licesë, certifikatë, autorizim, etj), Specialisti i Z1N rregjistron kërkesën dhe të dhënat bazë të aplikantit në sistemin kompjuterik dhe më pas printon nga sistemi formularin e kërkeses i cili përmban;

- Datën e kryerjes së aplikimit
- Numrin e praktikës<sup>1</sup>
- Drejtorinë që i drejtohet kërkesa
- Emërtimin e shërbimit
- Të dhënat bazë të aplikantit (emër,atësi,mbiemër,numër telefoni,etj)
- Bazën ligjore ku mbështetet kërkesa
- Afatin ligjor që do t'i kthehet përgjigjja

Formulari i kërkesës printohet nga Specialisti i Z1N në dy kopje dhe firmoset dhe nga Specialisti i Z1N dhe nga aplikanti. Njëra kopje i dorëzohet aplikantit, ndërsa kopja tjetër i bashkëngjitet dosjes fizike të tij.

### **Dokumenatacioni i aplikimit**

Kërkesa për shërbimin duhet të jetë e shoqëruar me dokumentacionin përkatës sipas akteve ligjore në fuqi. Specialisti i Z1N që pranon kërkesën e aplikantit duhet të sigurohet që aplikanti i ka bashkëngjitur kërkesës së tij dokumentacionin e kërkuar në formatin e duhur (origjinal, kopje e thjeshtë, kopje e njehësuar me origjinalin). Specialisti i Z1N duhet të bashkëngjit (attachoj ose scanojë) dokumentacionin e dorëzuar dhe ta hedh në dosjen elektronike të praktikës në sistemin e Zi1N.

Në rastin kur aplikanti nuk është i informuar rreth dokumentacionit që duhet të dorëzojë, Specialisti i Z1N shkarkon nga sistemi kompjuterik listën me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me bazën ligjore dhe i'a dorëzon aplikantit.

---

<sup>1</sup> Numri i praktikës del automatikisht nga sistemi dhe është i ndryshëm për cdo kërkesë.

Dorëzimi i të gjitha dosjeve fizike nga Specialisti i Z1N bëhet pranë Zyrës së Protokollit në fund të ditës, ku firmos për dorëzimin e tyre në librin e protokollit.

### **Verifikimi i shlyerjes së detyrime vendore**

Kërkesa i dërgohet njëkohësisht (automatiksht) Përgjegjësit të Sektorit në Sektorin e të Ardhurave i ngarkuar për këtë detyrë, i cili duhet të konfirmojë në sistem nëse aplikanti ka shlyer detyrimet vendore.

#### ***Rasti I: Subjekti nuk ka detyrime vendore të pashlyera***

Në rastin kur nga verifikimet rezulton se subjekti nuk ka detyrime vendore të pashlyera, kërkesa kalon automatiksht nëpërmjet sistemit për shqyrtim Sektorit të shëbimeve publike.

#### ***Rasti II: Subjekti ka detyrime vendore të pashlyera***

Në rastin kur nga verifikimet rezulton se subjekti ka detyrime vendore të pashlyera, Përgjegjësi i Sektorit në Sektorin e të Ardhurave liston detyrimet e pashlyera në sistem dhe ja kalon kërkesën sportelit të Z1N.

Specialisti i Z1N shkarkon faturën elektronike të përgatitur paraprakisht nga Sektori i të Ardhurave dhe ja dorëzon aplikantit për të kryer pagesën.

Aplikanti pasi kryen pagesën paraqitet pranë sportelit të Z1N dhe dorëzon një kopje të mandat pagesës.

Specialisti i Z1N plotëson në sistem numrin e mandatë pagesës, përzgjedh mënyrën e kryerjes së pagesës (bankë/arkë) dhe bashkëngjijt mandatin e pagesës në sistem.

Mandati i pagesës është i aksesushëm dhe nga Sektori i të Ardhurave dhe specialistët e zyrës e rregjistrojnë në sistemin e tyre të taksave.

Pas shlyerjes së detyrimeve vendore, Specialisti i Z1N e dërgon kërkesën për shqyrtim nëpërmjet sistemit pranë Sektorit të shëbimeve publike.

## **Shqyrtimi i kërkesës nga Sektori i Shëbimeve Publike**

Specialisti i pranë sektorit të shëbimeve publike njoftohet nëpërmjet sistemit në Listën e Punëve në momentin që ka kërkesa të reja për të trajtuar.

Ndërkohë, përgjegjësi pranë Zyrës së Protokollit dorëzon dosjet fizike pranë sektorit të shëbimeve publike.

Specialisti i Transportit Rrugor që merrë në dorëzim dosjen fizike firmos në librin e protokollit dhe vijon me shqyrtimin e kërkesës dhe dokumentacionit të bashkëngjitur (attachuar/scanuar) në sistem si edhe me dosjen fizike të dorëzuar.

Specialisti i Transportit Rrugor miraton ose refuzon kërkesën.

### ***Procedura e punës kur kërkesa miratohet***

Në rastin e miratimit të kërkesës Specialisti i Transportit plotëson të dhënat për dokumentin e kërkuar (licencë, certifikatë, leje, autorizim), të cilat përfshijnë numrin serial dhe periudhën e vlefshmërisë.

Specialisti i Transportit e përcjell informacionin me llogaritjen e detyrimit tek Sektori i të Ardhurave, e cila përgatit faturën për shërbim sipas tarifave të miratura në paketën fiskale dhe ja dërgon elektronikisht sportelit të Z1N.

Specialisti i Transportit printon dokumentin e kërkuar (licensë, certifikatë, leje, autorizim) në tre kopje;

- Një kopje me konceptim e cila ruhet në dosjen e Protokoll-Arkivit.
- Një kopje pa konceptim e cila i dorëzohet aplikantit.
- Një kopje pa konceptim e cila i shtohet dosjes fizike të aplikantit.

Të treja kopjet përcillen tek Kryetari i Bashkisë për t'u firmosur.

Dokumentat e firmosur dërgohen pranë Zyrës së Protokollit ku protokollohen.

Dokumenti me konceptoi qëndron fizikisht te Zyra e Protokollit, ndërsa dokumenti tjetër përcillet pranë Z1N.

Specialisti i Z1N që merr në dorëzim dokumentin firmos tek libri i protokollit.

Aplikanti njoftohet nga Speciliati i Z1N se përgjigjja e tij është gati. Kur aplikanti paraqitet në sportel Specialisti i Z1N shkarkon faturën e përgatitur paraprakisht nga Sektori i të Ardhurave dhe ja dorëzon aplikantit për të bërë pagesën.

Aplikanti pasi kryen pagesën, paraqitet pranë sportelit të Z1N dhe dorëzon një kopje të mandat pagesës.

Specialisti i Z1N plotëson disa të dhëna në sistem:

- *numrin e mandat pagesës,*
- *përzgjedh mënyrën e kryerjes së pagesës(bankë/arkë),*
- *bashkëngjit mandatin e pagesës në sistem.*

Specialisti i Z1N i dorëzon aplikantit dokumentin e përgjigjes (licensë, certifikatë, leje, autorizim) të firmosur nga kryetari. Gjithashtu, shkarkon nga sistemi formularin "Konfirmim për tërheqjen e dokumentit", i cili firmoset nga aplikanti.

### ***Procedura e punës kur kërkesa refuzohet***

Në rastin kur Specialisti i Transportit vendos që ta refuzojë kërkesën, argumenton arsyen për refuzimin dhe printon përgjigjen, e firmos dhe e dërgohen pranë Zyrës së Protokollit, ku protokollohet.

Specialisti pranë Sektorit të Protokollit e dorëzon pranë Specialistit të Z1N, i cili njofton aplikantin për përgjigjen.

Dokumenti me konceptoi qëndron fizikisht te Zyra e Protokollit, ndërsa dokumenti tjetër përcillet pranë Z1N.

Specialisti i Z1N që merrë në dorëzim dokumentin firmos tek libri i protokollit.

Aplikanti njoftohet nga Speciliati i Z1N se përgjigjja e tij është gati.



## **Procedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative me sistemin Z1N**

Njësia Administrative që ka të implementuar sistemin e zyrave të integruara me një ndalesë në territorin e Bashkisë Vau i Dejës, është Njësia Administrative Bushat.

### **Pranimi i kërkesës**

Në momentin që një aplikant paraqitet pranë sportelit të Z1N në Njësinë Administrative për të aplikuar, Specialisti i Z1N rregjistron kërkesën dhe të dhënat bazë të aplikantit në sistemin kompjuterik dhe më pas printon nga sistemi formularin e kërkeses i cili përmban;

- Datën e kryerjes së aplikimit
- Numrin e praktikës
- Drejtorinë që i drejtohet kërkesa
- Emërtimin e shërbimit
- Të dhënat bazë të aplikantit (emër,atësi,mbiemër,numër telefoni,etj)
- Bazën ligjore ku mbështetet kërkesa
- Afatin ligjor që do t'i kthehet përgjigjja

Formulari i kërkesës printohet nga Specialisti i Z1N në dy kopje dhe firmoset dhe nga Specialisti i Z1N dhe nga aplikanti. Njëra kopje i dorëzohet aplikantit, ndërsa kopja tjetër i bashkëngjitet dosjes fizike të tij.

### **Dokumenatacioni i aplikimit**

Kërkesa për shërbimin duhet të jetë e shoqëruar me dokumentacionin përkatës sipas akteve ligjore në fuqi. Specialisti i Z1N që pranon kërkesën e aplikantit duhet të sigurohet që aplikanti i ka bashkëngjitur kërkesës së tij dokumentacionin e kërkuar në formatin e duhur (origjinal, kopje e thjeshtë, kopje e njehësuar me origjinalin). Specialisti i Z1N duhet të bashkëngjit (attachoj ose scanojë) dokumentacionin e dorëzuar dhe ta hedh në dosjen elektronike të praktikës në sistemin e Zi1N.

Në rastin kur aplikanti nuk është i informuar rreth dokumentacionit që duhet të dorëzojë, Specialisti i Z1N shkarkon nga sistemi kompjuterik listën me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me bazën ligjore dhe ia dorëzon aplikantit.

Në momentin që aplikanti ka dorëzuar dokumentacionin e plotë, Specialisti i Z1N e përcjellë dosjen fizike pranë zyrës së protokollit dhe firmos në librin e protokollit.

### **Verifikimi i shlyerjes së detyrime vendore**

Specialisti i Z1N e dërgon kërkesën elektronikisht për verifikim të shlyerjes së detyrimeve vendore, pranë Sektorit të të Ardhurave në Njësi Administrative.

#### ***Rasti I: Subjekti nuk ka detyrime vendore të pashlyera***

Në rastin kur nga verifikimet rezulton se subjekti nuk ka detyrime vendore të pashlyera, kërkesa kalon për shqyrtim pranë sektorit të shëbimeve publike, Bashkia Vau Dejës.

#### ***Rasti II: Subjekti ka detyrime vendore të pashlyera***

Në rastin kur nga verifikimet rezulton se subjekti ka detyrime vendore të pashlyera, përgjegjësi për verifikimin e shlyerjes së detyrimeve, liston detyrimet e pashlyera në sistem dhe i'a kalon kërkesën sportelit të Z1N në Njësi Administrative.

Specialisti i Z1N shkarkon faturën elektronike të përgatitur paraprakisht nga Sektori i të Ardhurave dhe ja dorëzon aplikantit për të kryer pagesën.

Aplikanti pasi kryen pagesën paraqitet pranë sportelit të Z1N dhe dorëzon një kopje të mandat pagesës.

Specialisti i Z1N plotëson në sistem numrin e mandat pagesës, përzgjedh mënyrën e kryerjes së pagesës (bankë/arkë) dhe bashkëngjit mandatin e pagesës në sistem.

Mandati i pagesës është i aksesueshëm dhe nga Sektori i të Ardhurave të cilët e regjistrojnë mandat pagesën në sistemin e tyre të taksave.

## **Shqyrtimi i kërkesës nga sektori i shëbimeve publike, Bashkia Vau i Dejës**

Pas shlyerjes së detyrimeve vendore, Specialisti i Z1N e dërgon kërkesën për shqyrtim pranë Sektorit të shëbimeve publike, në Bashkinë Vau i Dejës.

Për verifikueshmërinë e dokumentacionit është e nevojshme që dosja fizike e aplikantit të dërgohet fizikisht pranë sektorit të shëbimeve publike në Bashkinë Vau i Dejës.

Një njësitë administrative përcaktohet një periudhë kohore gjatë të cilës përcillen dosjet pranë Bashkisë Vau i Dejës.

Personi që merrë në dorëzim dosjet fizike për t'i transferuar pranë Bashkisë Vau i Dejës, firmos pranë Zyrës së Protokollit të Njësisë Administrative për marrjen në dorëzim të tyre dhe pranë Zyrës së Protokollit në Bashkinë Vau i Dejës për dorëzimin e tyre.

Dosjet fizike protokollohen të gjitha nga Zyra e Protokollit.

Specialisti pranë Zyrës së Protokollit i përcjell dosjet fizike pranë sektorit të shëbimeve publike për t'u shqyrtuar.

Specialisti i Transportit që merrë në dorëzim dosjet fizike, firmos në librin e protokollit.

Zyra e transportit rrugor shqyrton dokumentacionin e bashkëngjitur (attachuar/scanuar) në sistem si edhe dosjen fizike të dorëzuar dhe trajton kërkesën.

### ***Proçedura e punës kur kërkesa miratohet***

Specialisti i Transportit printon dokumentin e kërkuar (licensë, certifikatë, leje, autorizim) në tre kopje;

- Një kopje me konceptim e cila ruhet në dosjen e Protokollit.
- Një kopje pa konceptim e cila i dorëzohet aplikantit.
- Një kopje pa konceptim e cila i shtohet dosjes fizike të aplikantit.

Të treja kopjet përcillen tek Kryetari i Bashkisë për t'u firmosur.

Dokumentat e firmosur dërgohen pranë Zyrës së Protokollit ku protokollohen, ku ruhet edhe dokumenti me konceptim.

Njëra kopje pa konceptim, ruhet në dosjen fizike të aplikantit. Kopja tjetër pa konceptim përcillet pranë sportelit të Z1N në Njësi Administrative për t'ju dorëzuar aplikantit.

Specialisti i Z1N që merr në dorëzim dokumentin firmos tek libri i protokollit.

Dokumenti i firmosur nga kryetari përcillet fizikisht pranë Njesisë Administrative ku është kryer kërkesa. Personi që ngarkohet për transferimin e dokumentave (licensën, certifikatën, autorizimin, etj) nga bashkia në njësinë administrative, firmos pranë librit të protokollit në Bashkinë Vau i Dejës për tërheqjen e dokumentave dhe pranë Njesisë Administrative për dorëzimin e tyre.

Në librin e protokollit të Njësive Administrative do të firmosi edhe Specialisti i Z1N për marrjen në dorëzim të licensave.

Aplikanti njoftohet nga Specialisti Z1N se përgjigjja e tij është gati. Kur aplikanti paraqitet në sportel Specialisti i Z1N shkarkon faturën e përgatitur paraprakisht nga Sektori i të Ardhurave në Bashkinë Vau Dejës dhe ia dorëzon aplikantit për të bërë pagesën.

Aplikanti pasi kryen pagesën, paraqitet pranë sportelit të Z1N dhe dorëzon një kopje të mandat pagesës.

Specialisti i Z1N plotëson disa të dhëna në sistem:

- *numrin e mandat pagesës,*
- *përzgjedh mënyrën e kryerjes së pagesës (bankë/arkë),*
- *bashkëngjit mandatin e pagesës në sistem.*

Specialisti i Z1N i dorëzon aplikantit dokumentin e përgjigjes (licensë, certifikatë, leje, autorizim) të firmosur nga kryetari. Gjithashtu, shkarkon nga sistemi formularin "Konfirmim për tërheqjen e dokumentit", i cili firmoset nga aplikanti.

### ***Proçedura e punës kur kërkesa refuzohet***

Në rastin kur Specialisti i Transportit vendos që ta refuzojë kërkesën, argumenton arsyen për refuzimin dhe printon përgjigjen, e firmos dhe e dërgohen pranë Zyrës së Protokollit ku protokollohet.

Specialisti pranë Sektorit të Protokollit e dorëzon pranë Specialistit të Z1N në Njësi Administrative, ku specialisti i Z1N cili njofton aplikatin për përgjigjen. Specialisti i pranë Zyrës me Një Ndalesë në Njësi Administrative njofton aplikantin për përgjigjen dhe pas dorëzimit të përgjigjes, klikon në sistemin kompjuterik se përgjigjia u dorëzua.

## **Procedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative pa sistem**

### **Rasti I: Aplikanti aplikon vetë pranë Bashkisë Vau i Dejës për shërbim**

Në rastin kur një aplikant, banor i një Njësie Administrative ku nuk është implementuar sistemi i zyrave të integruara me një ndalesë, aplikon për shërbim transporti pranë Bashkisë Vau i Dejës procedura e punës do të jetë si në **Rastin e parë**.

Aplikanti në listën e dokumentave që do të dorëzojë duhet të ketë të bashkëngjitur edhe një mandat pagese të lëshura nga Administratori i Njesisë Administrative, e cila i lejon Sektorit të të Ardhurave të vijojë me procedurën për konfirmimin e shlyerjes së detyrimeve vendore dhe më pas të vijojë procedura për shqyrtimin e kërkesave.

### **Rasti II: Njësia administrative kërkon shqyrtimin e kërkesave**

Punonjësit e Njësive Administrative që nuk e kanë të implementuar sistemin e Zyrave me Një Ndalesë do të pranojnë kërkesat e aplikantëve për shërbimet e transportit rrugor dhe do të marrin në dorëzim dokumentacionin e dorëzuar prej tyre, pasi të kenë verifikuar pagesën e taksave dhe tarifave vendore. Një kopje e mandat arkëtimit, i bashkëlidhet dokumentacionit, që vërteton kryerjen e pagesës. Personi përgjegjës për cdo njësi administrative që do të marrë përsipër transferimin e dosjeve nga Njësia Administrative në Bashkinë Vau i Dejës do të firmosi në librin e protokollit të njësisë administrative për marrjen në dorëzim të tyre dhe në librin e protokollit në Bashkinë Vau i Dejës për dorëzimin e tyre. Dosjet fizike rregjistrohen të gjitha në librin e protokollit.

Pas protokollimit të dosjeve fizike, specialisti i pranë Zyrës së Protokollit do t'i përcjellë dosjet fizike pranë sportelit të Z1N. Specialistët e Z1N i rregjistrojnë të gjitha kërkesat në sistem dhe procedura e punës vijon sipas **Rastit të pestë**. Kërkesat pasi janë miratuar ose refuzuar nga Sektori i Transportit, mbledhen dhe dërgohen pranë Njësive Administrative nga ku është bërë aplikimi.

Personi përgjegjës nga cdo Njësi Administrative që merrë përsipër transferimin e dokumentave nga Bashkia Vau i Dejës në Njësinë Administrative, do të firmosi pranë librit të protokollit në Bashkinë Vau i Dejës për tërheqjen e dokumentave dhe pranë Njesisë Administrative për dorëzimin e tyre. Gjithashtu, në librin e protokollit të Njësive Administrative do të firmosi edhe punonjësi i njësisë administrative për marrjen në dorëzim të dokumentave

## **Sektori i Urbanistikës, kadastër**

### **Lista e shërbimeve**

Sektori i urbanistikës në Bashkinë Vau i Dejës dhe Njësitë Administrative që kanë të implementuar Sistemin e Integruar të Zyrave me Një Ndalesë, ofrojnë këto shërbime:

1. Leje për vendosje reklamash
2. Leje për shrytëzim të hapësirës publike
3. Kerkese per vendosje lojrash ne hapesire publike
4. Vertetim per trajtim prone mbi objektet e ndertuara deri me 10-08-1991
5. Vertetim pagese takse infrastrukture per legalizim
6. Kerkese per t'u pajisur me leje per shites ambulant
7. Leje për veprimtari muzikore mbas ores 23<sup>00</sup>
8. Leje non stop-Lojra fati dhe kazinote
9. Leje non stop –Karburante
10. Konfirmim Kufizim Prone Private me Pronë Shtet

### **Baza ligjore**

Hartimi i procedurave administrative dhe formularëve-tip, është mbështetur në legjislacionin e mëposhtëm;

- ✓ Ligj Nr.107/2014” Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; i ndryshuar
- ✓ VKM Nr.408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar
- ✓ VKM Nr.671/2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”
- ✓ Vendim nr.175 datë 21.3.2016 “Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave publike”

## **Procedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Bashkisë Vau i Dejës**

### **Pranimi i kërkesës**

Në momentin që një aplikant paraqitet pranë sportelit të Z1N në Bashkinë Vau i Dejës për të aplikuar për një shërbim që i përket sektorit të urbanistikës, Specialisti i Z1N rregjistron kërkesën dhe të dhënat bazë të aplikantit në sistemin kompjuterik dhe më pas printon nga sistemi formularin e kërkeses i cili përmban;

- Datën e kryerjes së aplikimit
- Numrin e praktikës
- Drejtorinë që i drejtohet kërkesa
- Emërtimin e shërbimit
- Të dhënat bazë të aplikantit (emër, atësi, mbiemër, numër telefoni, etj)
- Bazën ligjore ku mbështetet kërkesa
- Afatin ligjor që do t'i kthehet përgjigjja

Formulari i kërkesës printohet nga Specialisti i Z1N në dy kopje dhe firmoset dhe nga Specialisti i Z1N dhe nga aplikanti. Njëra kopje i dorëzohet aplikantit, ndërsa kopja tjetër i bashkëngjitet dosjes fizike të tij.

### **Dokumenatacioni i aplikimit**

Kërkesa për shërbimin duhet të jetë e shoqëruar me dokumentacionin përkatës sipas akteve ligjore në fuqi. Specialisti i Z1N që pranon kërkesën e aplikantit duhet të sigurohet që aplikanti i ka bashkëngjitur kërkesës së tij dokumentacionin e kërkuar në formatin e duhur (origjinal, kopje e thjeshtë, kopje e njehësuar me origjinalin). Specialisti i Z1N duhet të bashkëngjit (attachoj ose scanojë) dokumentacionin e dorëzuar dhe ta hedh në dosjen elektronike të praktikës në sistemin e Zi1N.

Dorëzimi i të gjitha dosjeve fizike nga Specialisti i Z1N bëhet pranë Zyrës së Protokollit në fund të ditës, ku firmos për dorëzimin e tyre në librin e protokollit.



## **Verifikimi i shlyerjes së detyrime vendore**

Kërkesa i dërgohet njëkohësisht (automatiksht) Përgjegjësit të Sektorit në Sektorin e të Ardhurave i ngarkuar për këtë detyrë, i cili duhet të konfirmojë në sistem nëse aplikanti ka shlyer detyrimet vendore.

### ***Rasti I: Subjekti nuk ka detyrime vendore të pashlyera***

Në rastin kur nga verifikimet rezulton se subjekti nuk ka detyrime vendore të pashlyera, kërkesa kalon automatiksht nëpërmjet sistemit për shqyrtim sektorit të urbanistikës.

### ***Rasti II: Subjekti ka detyrime vendore të pashlyera***

Në rastin kur nga verifikimet rezulton se subjekti ka detyrime vendore të pashlyera, përgjegjësi i Sektorit në Sektorin e të Ardhurave liston detyrimet e pashlyera në sistem dhe ja kalon kërkesën sportelit të Z1N.

Specialisti i Z1N shkarkon faturën elektronike të përgatitur paraprakisht nga Sektori i të Ardhurave dhe ja dorëzon aplikantit për të kryer pagesën.

Aplikanti pasi kryen pagesën paraqitet pranë sportelit të Z1N dhe dorëzon një kopje të mandat pagesës.

Specialisti i Z1N plotëson në sistem numrin e mandate pagesës, përzgjedh mënyrën e kryerjes së pagesës (bankë/arkë) dhe bashkëngjit mandatin e pagesës në sistem.

Mandati i pagesës është i aksesushëm dhe nga Sektori i të Ardhurave dhe specialistët e zyrës e rregjistrojnë në sistemin e tyre të taksave.

Pas shlyerjes së detyrimeve vendore, Specialisti i Z1N e dërgon kërkesën për shqyrtim nëpërmjet sistemit pranë sektorit të urbanistikës.

## **Shqyrtimi i kërkesës nga sektori i urbanistikës**

Specialisti i ngarkuar për shqyrtimin e kërkesave pranë sektorit të urbanistikës njoftohet nëpërmjet sistemit në Listën e Punëve se ka kërkesa të reja për të shqyrtuar.

Ndërkohë, Përgjegjësi pranë Sektorit të Protokollit dorëzon dosjet fizike pranë sektorit të urbanistikës.

Specialisti i i sektorit të urbanistikës që merrë në dorëzim dosjen fizike firmos në librin e protokollit dhe vijon me shqyrtimin e kërkesës dhe dokumentacionit të bashkëngjitur (attacuar/scanuar) në sistem si edhe me dosjen fizike të dorëzuar.

Specialisti i sektorit të urbanistikës miraton ose refuzon kërkesën.

## ***Procedura e punës kur kërkesa miratohet***

Në rastin e miratimit të kërkesës specialisti i sektorit të urbanistikës, i ngarkuar për trajtimin e kërkesave plotëson të dhënat për dokumentin e kërkuar.

Specialisti i sektorit të urbanistikës e përcjell informacionin me llogaritjen e detyrimit tek Sektori i të Ardhurave, e cila përgatit faturën për shërbim sipas tarifave të miratura në paketën fiskale dhe ja dërgon elektronikisht sportelit të Z1N.

Specialisti i sektorit të urbanistikës printon dokumentin e kërkuar (leje shfrytëzimi hapësire publike, leje për shitës ambulant, etj) në tre kopje;

- Një kopje me konceptim e cila ruhet në dosjen e Protokollit.
- Një kopje pa konceptim e cila i dorëzohet aplikantit.
- Një kopje pa konceptim e cila i shtohet dosjes fizike të aplikantit.

Të treja kopjet përcillen tek Kryetari i Bashkisë për t'u firmosur.

Dokumentat e firmosur dërgohen pranë Sektorit të Protokollit ku protokollohen, ku ruhet edhe dokumenti me konceptim.

Njëra kopje pa konceptim ruhet në dosjen fizike të aplikantit.

Kopja tjetër pa konceptim përcillet pranë sportelit të Z1N për t'ja dorëzuar aplikantit nga specialisti i Z1N.

Specialisti i Z1N që merrë në dorëzim dokumentin firmos tek libri i protokollit.

Aplikanti njoftohet nga Specialisti i Z1N se përgjigja e tij është gati. Kur aplikanti paraqitet në sportel Specialisti i Z1N shkarkon faturën e përgatitur paraprakisht nga Sektori i të Ardhurave dhe ja dorëzon aplikantit për të bërë pagesën.

Aplikanti pasi kryen pagesën, paraqitet pranë sportelit të Z1N dhe dorëzon një kopje të mandat pagesës.

Specialisti i Z1N plotëson disa të dhëna në sistem:

- *numrin e mandatë pagesës,*
- *përzgjedh mënyrën e kryerjes së pagesës(bankë/arkë),*
- *bashkëngjit mandatin e pagesës në sistem.*

Specialisti i Z1N i dorëzon aplikantit dokumentin e përgjigjes të firmosur nga kryetari. Gjithashtu, shkarkon nga sistemi formularin "*Konfirmim për tërheqjen e dokumentit*", i cili firmoset nga aplikanti.

### ***Procedura e punës kur kërkesa refuzohet***

Në rastin kur Specialisti i Zyrës së Urbanistikës vendos që ta refuzojë kërkesën, argumenton arsyen për refuzimin dhe printon përgjigjen, e firmos dhe e dërgon pranë Zyrës së Protokollit ku protokollohet.

Specialisti pranë Sektorit të Protokollit e dorëzon pranë Specialistit të Z1N.

Specialisti pranë Zyrës me Një Ndalesë në Bashki njofton aplikantin për përgjigjen dhe pas dorëzimit të përgjigjes, klikon në sistemin kompjuterik se përgjigja u dorëzua.

## **Proçedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative me sistemin Z1N**

### **Pranimi i kërkesës**

Në momentin që një aplikant paraqitet pranë sportelit të Z1N në Njësitë Administrative për të aplikuar për një shërbim që i përket sektorit të urbanistikës, Specialisti i Z1N rregjistron kërkesën dhe të dhënat bazë të aplikantit në sistemin kompjuterik dhe më pas printon nga sistemi formularin e kërkeses i cili përmban;

- Datën e kryerjes së aplikimit
- Numrin e praktikës
- Drejtorinë që i drejtohet kërkesa
- Emërtimin e shërbimit
- Të dhënat bazë të aplikantit (emër,atësi,mbiemër,numër telefoni,etj)
- Bazën ligjore ku mbështetet kërkesa
- Afatin ligjor që do t'i kthehet përgjigjja

Formulari i kërkesës printohet nga Specialisti i Z1N në dy kopje dhe firmoset dhe nga Specialisti i Z1N dhe nga aplikanti. Njëra kopje i dorëzohet aplikantit, ndërsa kopja tjetër i bashkëngjitet dosjes fizike të tij.

### **Dokumenatacioni i aplikimit**

Kërkesa për shërbimin duhet të jetë e shoqëruar me dokumentacionin përkatës sipas akteve ligjore në fuqi. Specialisti i Z1N që pranon kërkesën e aplikantit duhet të sigurohet që aplikanti i ka bashkëngjitur kërkesës së tij dokumentacionin e kërkuar në formatin e duhur (origjinal, kopje e thjeshtë, kopje e njehësuar me origjinalin). Specialisti i Z1N duhet të bashkëngjitet (attachoj ose scanojë) dokumentacionin e dorëzuar dhe ta hedh në dosjen elektronike të praktikës në sistemin e Zi1N.

Në momentin që aplikanti ka dorëzuar dokumentacionin e plotë, Specialisti i Z1N e përcjellë dosjen fizike pranë Zyrës së Protokollit dhe firmos në librin e protokollit.

## **Verifikimi i shlyerjes së detyrime vendore**

Specialisti i Z1N e dërgon kërkesën për verifikim të shlyerjes së detyrimeve vendore pranë Sektorit të të Ardhurave në Njësi Administrative.

### ***Rasti I: Subjekti nuk ka detyrime vendore të pashlyera***

Në rastin kur nga verifikimet rezulton se subjekti nuk ka detyrime vendore të pashlyera, kërkesa kalon për shqyrtim pranë Sektorit të urbanistikës, Bashkia Vau i Dejës.

### ***Rasti II: Subjekti ka detyrime vendore të pashlyera***

Në rastin kur nga verifikimet rezulton se subjekti ka detyrime vendore të pashlyera, përgjegjësi për verifikimin e shlyerjes së detyrimeve, liston detyrimet e pashlyera në sistem dhe ja kalon kërkesën sportelit të Z1N.

Specialisti i Z1N shkarkon faturën elektronike të përgatitur paraprakisht nga përgjegjësi për verifikimin e shlyerjes së detyrimeve dhe ia dorëzon aplikantit për të kryer pagesën.

Aplikanti pasi kryen pagesën paraqitet pranë sportelit të Z1N dhe dorëzon një kopje të mandat pagesës.

Specialisti i Z1N plotëson në sistem numrin e mandat pagesës, përzgjedh mënyrën e kryerjes së pagesës (bankë/arkë) dhe bashkëngjit mandatin e pagesës në sistem.

Mandati i pagesës është i aksesueshëm dhe nga përgjegjësit për verifikimin e shlyerjes së detyrimeve të cilët e rregjistrojnë mandat pagesën në sistemin e tyre të taksave.

## **Shqyrtimi i kërkesës nga sektori i urbanistikës, Bashkia Vau i Dejës**

Pas shlyerjes së detyrimeve vendore, Specialisti i Z1N e dërgon kërkesën për shqyrtim pranë sektorit të urbanistikës, në Bashkinë Vau i Dejës.

Për verifikueshmërinë e dokumentacionit është e nevojshme që dosja fizike e aplikantit të dërgohet fizikisht pranë sektorit të urbanistikës në Bashkinë Vau i Dejës.

Një njësitë administrative përcaktohet një periudhë kohore gjatë të cilës përcillen dosjet pranë Bashkisë Vau i Dejës.

Personi që merrë në dorëzim dosjet fizike për t'i transferuar pranë Bashkisë Vau i Dejës, firmos pranë Zyrës së Protokollit të Njësisë Administrative për marrjen në dorëzim të tyre dhe pranë Zyrës së Protokollit në Bashkinë Vau i Dejës për dorëzimin e tyre.

Dosjet fizike protokollohen të gjitha nga Zyra e Protokollit.

Specialisti i pranë Zyrës së Protokollit i përcjellë dosjet fizike pranë sektorit të urbanistikës për t'u shqyrtuar.

Specialisti i i sektorit të urbanistikës që merrë në dorëzim dosjet fizike, firmos në librin e protokollit.

Sektori i urbanistikës shqyrton dokumentacionin e bashkëngjitur (attachuar/scanuar) në sistem si edhe dosjen fizike të dorëzuar dhe trajton kërkesën.

Specialisti i sektorit të urbanistikës e printon dokumentin në tre kopje;

- Një kopje me konceptim e cila ruhet në dosjen e Protokollit.
- Një kopje pa konceptim e cila i dorëzohet aplikantit.
- Një kopje pa konceptim e cila i shtohet dosjes fizike të aplikantit.

Të treja kopjet përcillen tek Kryetari i Bashkisë për t'u firmosur.

Dokumentat e firmosur dërgohen pranë Zyrës së Protokollit ku protokollohen, ku ruhet edhe dokumenti me konceptim.

Njëra kopje pa konceptim ruhet në dosjen fizike të aplikantit.

Kopja tjetër pa konceptim përcillet pranë sportelit të Z1N në Njësi Administrative për t'ja dorëzuar aplikantit nga Specialisti i Z1N.

Specialisti i Z1N që merrë në dorëzim dokumentin firmos tek libri i protokollit.

Personi që ngarkohet për transferimin e dokumentave nga bashkia në njësitë administrative, firmos pranë librit të protokollit në Bashkinë Vau i Dejës për tërheqjen e dokumentave dhe pranë Njësisë Administrative për dorëzimin e tyre.

### ***Procedura e punës kur kërkesa refuzohet***

Në rastin kur Specialisti i Zyrës së Urbanistikës vendos që ta refuzojë kërkesën, argumenton arsyen për refuzimin dhe printon përgjigjen, e firmos dhe e dërgohen pranë Zyrës së Protokollit ku protokollohet.

Specialisti pranë Sektorit të Protokollit e dorëzon dokumentin pranë Specialistit të Z1N në Njësi Administrative, ku specialisti i Z1N njofton aplikatin për përgjigjen dhe pas dorëzimit të përgjigjes, klikon në sistemin kompjuterik se përgjigjia u dorëzua.

## **Procedura e punës kur kërkesa bëhet pranë Njësive Administrative pa sistem**

### **Rasti I: Aplikanti aplikon vetë pranë Bashkisë Vau i Dejës për shërbim**

Në rastin kur një aplikant, banor i një njësie administrative ku nuk është implementuar Sistemi i Zyrave të Integruara me Një Ndalesë, aplikon për shërbim që i përket sektorit të urbanistikës pranë Bashkisë Vau i Dejës procedura e punës do të jetë si në **Rastin e parë**.

Aplikanti në listën e dokumentave që do të dorëzojë duhet të ketë të bashkëngjitur edhe një mandat pagese të lëshur nga administratori i njësisë administrative, e cila i lejon Zyrës së të Ardhurave të vijojë me procedurën për konfirmimin e shlyerjes së detyrimeve vendore dhe të vijojë procedura për shqyrtimin e kërkesave.

### **Rasti II: Njësia administrative kërkon shqyrtimin e kërkesave**

Punonjësit e Njësive Administrative që nuk e kanë të implementuar Sistemin e Zyrave me Një Ndalesë do të pranojnë kërkesat e aplikantëve për shërbimet e sektorit të urbanistikës dhe do të marrin në dorëzim dokumentacionin e dorëzuar prej tyre. Personi përgjegjës për cdo njësi administrative që do të marrë përsipër transferimin e dosjeve nga Njësia Administrative në Bashkinë Vau i Dejës do të firmosi në librin e protokollit të Njësisë Administrative për marrjen në dorëzim të tyre dhe në librin e protokollit të Bashkinë Vau i Dejës për dorëzimin e tyre. Dosjet fizike rregjistrohen të gjitha në librin e protokollit.

